


Arsimimi dhe aftësimi në ndërmarrësi

Udhëzues për mësimdhënës



Publikimi është përpiluar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e kontraktuesit, PEM GmbH dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



PËRMBAJTJA

Standardet e mësimit për ndërmarrësi për nivelin 1	1
KAPITULLI 1 – Karakteristikat e ndërmarrësit të suksesshëm	6
NJËSIA MËSIMORE 1	7
NJËSIA MËSIMORE 2	9
NJËSIA MËSIMORE 3	12
NJËSIA MËSIMORE 4	13
KAPITULLI 2 – Zhvillimi i idesë afariste	15
NJËSIA MËSIMORE 1	16
NJËSIA MËSIMORE 2	17
NJËSIA MËSIMORE 3	18
NJËSIA MËSIMORE 4	19
KAPITULLI 3 – Shtjellimi i planit afarist	20
NJËSIA MËSIMORE 1	21
NJËSIA MËSIMORE 2	22
NJËSIA MËSIMORE 3	23
KAPITULLI 4 – Klientët dhe shitësit	24
NJËSIA MËSIMORE 1	25
NJËSIA MËSIMORE 2	2
KAPITULLI 5 – Organizimi dhe menaxhimi	3
NJËSIA MËSIMORE 1	4
NJËSIA MËSIMORE 2	6
KAPITULLI 6 – Produktet dhe shërbimet	7
NJËSIA MËSIMORE 1	8
NJËSIA MËSIMORE 2	2
KAPITULLI 7 – Investimet dhe financat	3
NJËSIA MËSIMORE 1	4
NJËSIA MËSIMORE 2	7
KAPITULLI 8 dhe 9 – Loja me role dhe vlerësimi	8
Aneks - Materiali i shtypur	10
KAPITULLI 1	11
NJËSIA MËSIMORE 2	11
NJËSIA MËSIMORE 4	12
KAPITULLI 2	13

NJËSIA MËSIMORE 3	13
NJËSIA MËSIMORE 4	14
KAPITULLI 3	15
NJËSIA MËSIMORE 1 DHE 2.....	15
KAPITULLI 4	16
NJËSIA MËSIMORE 1	16
KAPITULLI 5	17
KAPITULLI 6	18
KAPITULLI 7	19

Standardet e mësimit për ndërmarrësi për nivelin 1

Mësimdhënësit e *shkollave fillore dhe të mesme* e inkurajojnë vetëdijesimin për ndërmarrësi, si opsion për karrierë për çdonjërin dhe si mënyrë për të theksuar rëndësinë e matematikës, shkencave, arteve, gjuhëve dhe lëndëve shoqërore. Ndërmarrësia bëhet mjet për zhvillimin e shkathtësive akademike dhe për të kuptuar sistemin e lirë të ndërmarrjes.

Mësimi i ndërmarrësisë përfshin dy elemente të ndryshme:

- Një koncept të gjerë të **mësimit të shkathtësive** dhe shprehive **për ndërmarrës**, që përfshinë zhvillimin e kualiteteve të caktuara personale dhe nuk fokusohet drejtpërdrejtë në krijimin e bizneseve të reja.
- Një koncept më i veçantë për **mësimin e mundësive të ndërmarrjes** lidhur me krijimin, udhëheqjen dhe mbylljen e një biznesi.
- Mësimi për ndërmarrësi, **në nivel të arsimit fillor**, synon të kultivojë në nxënës **kualitetet personale**, siç janë kreativiteti, shpirti i iniciativës dhe pavarësisë, që kontribuojnë në zhvillimin e një qëndrimi për ndërmarrësi, që do të dëshmojnë si të dobishme në jetën e tyre dhe në çdo aktivitet punues. Në këtë fazë, do të zhvillohen format autonome dhe aktive të mësimit. Për më tepër, ky mësim do të ofrojë njohuri fillestare dhe kontakte me botën e biznesit si dhe pjesë të të kuptuarit për rolin e ndërmarrësve në komunitet. Aktivitetet mund të përfshijnë punën në projekte, të mësuarit përmes lojës, prezantimin e studimeve të rasteve të thjeshta praktike dhe vizitat te ndërmarrjet vendore.

Zhvillimi i kompetencave

Pasi standardet e mësimimit për ndërmarrësi nuk kanë të bëjnë me një standard të vetëm profesional, por më tepër mbulojnë një shumëllojshmëri të shkathtësive profesionale, nxënësit, të cilat angazhohen në mësimin për ndërmarrësi, mund të përvetësojnë kompetenca të ndryshme, varësisht nga fokusimi i mësimimit të tyre:

- **kompetenca për ndërmarrësi**
shkathtësitë teknike, njohuritë dhe të kuptuarit në organizimin e biznesit/ndërmarrjes, si dhe shkathtësitë personale dhe qëndrimet që definojnë një ndërmarrës; rrisin shkathtësitë e ndërmarrësisë, që gjithashtu përfshijnë:
 - punën me prodhimtarinë ose kompanitë e shpërndara (gjeografikisht)
 - punën në gjuhë të huaja
- **kompetenca profesionale dhe për arsim profesional**
shkathtësitë kryesore, njohuritë dhe të kuptuarit si zgjidhja e problemit, puna me tjerët, TIK dhe siguria dhe shëndetësia; por gjithashtu shkathtësitë, njohuritë dhe të kuptuarit, që kanë lidhshmëri me profesionet dhe vendet e ndryshme të punës (p.sh. financat, shitja me pakicë) dhe çështjet e ambientit.
- **Komunikimi dhe kompetenca sociale**
shkathtësitë kryesore, njohuritë dhe të kuptuarit në komunikim efektiv dhe aktivitete ndërnjerëzore e, gjithashtu në çështjet etike, morale dhe kulturore.
- **kompetenca personale**
zhvillimi i autonomisë, përgjegjësisë, rolit personal, realizimit dhe të nxënimit vetanak.

Prandaj, mësimi për ndërmarrësi përfshinë zhvillimin e:

- **aftësitë për ndërmarrje:**
 - trajtimi i pasigurive
 - reagimi në mënyrë pozitive në ndryshime
 - krijimi dhe zbatimi i ideve të reja
 - krijimi dhe zbatimi i mënyrave të reja për të punuar
 - vlërësimi i rrezikut/shpërblimit
 - aplikimi i këtyre aftësive në jetën personale dhe punuese
- **aftësitë personale :**
(shkathtësitë për ndërmarrësi)
 - risitë
 - kreativiteti
 - menaxhimi i rrezikut
 - qëndrimi mund-bëj
 - pavarësia
 - iniciativa
 - përgjegjësia
 - shtytja, që gjërat të funksionojnë

Mësimi mund të mbështet nga zhvillimi i:

- **aftësive të tjera në:**
(shembujt)
 - shkathtësitë kryesore dhe gjuhët e huaja
 - menaxhim
 - ekonomi
 - studimet e biznesit
 - administratë
 - financë
 - marketing
 - shitje
 - shitje me pakicë
 - shërbim për klientë
 - menaxhim të cilësisë
 - burime njerëzore
 - aftësim dhe zhvillim

Prandaj, mësimi për ndërmarrësi duhet të inkurajojë:

- Mundësitë për nxënësit të zhvillojnë aftësinë e tyre në **zgjidhjen e problemeve**. Kjo nënkupton inkurajimin e aftësisë në **planifikim, komunikim, marrjen e vendimit** dhe gatishmërinë për të marr **përgjegjësinë**.
- mundësitë për nxënësit të zhvillojnë aftësinë e tyre për të **bashkëpunuar, zhvilluar rrjetin** dhe për të **marr role të reja**.
- mundësitë për nxënësit të zhvillojnë **vetë-besimin** e tyre, **motivimin** për të punuar, të **mësojnë për të menduar në mënyrë kritike** dhe në mënyrë të pavarur, të fitojnë vullnetin dhe aftësinë për të **mësuar në mënyrë autonome**.
- mundësitë për nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre për të treguar **iniciativën, pro-aktivitetin** dhe **kreativitetin** personal, si dhe të përgatiten për tu **ballafaquar me rreziqe**, në bashkëveprim me **idetë për zbatim**.

Përveç shkathtësive lidhur me aspektet e veçanta të kompetencës teknike dhe ndërmarrësisë, ekzistojnë një numër i shkathtësive të përgjithshme personale, ndër-njerëzore dhe atributet personale, që nxënësit mund t'i përvetësojnë gjatë mësimit për ndërmarrësi.

Shembuj të shkathtësive personale:

- analizimi dhe vlerësimi
- monitorimi dhe rishikimi
- planifikimi dhe caktimi i prioriteteve
- caktimi i objektivave
- menaxhimi i kohës
- hulumtimi dhe studimi
- vetë-reflektimi kritik
- identifikimi, interpretimi dhe aplikimi i njohurive të veçanta në praktikë
- zgjidhja e problemit
- të qenit kreativ
- marrja e vendimit

- menaxhimi i konfliktit
- krijimi i marrëdhënieve efektive të punës, në bashkëpunim me të tjerët
- komunikimi efektiv me grupet dhe individët me referencë të veçantë për:
 - përgatitjen e materialeve efektive me shkrim
 - shkathtësitë e të dëgjuarit dhe pyeturit
 - sqarimin e ideve në mënyrë të qartë
 - ofrimin e informatës kthyes konstruktive
 - kontributi në diskutimet e grupit
- rrjeti
- intervista dhe negocimi
- menaxhimi i vetvetes dhe menaxhimi i ndërrimeve
- prezantimi dhe shpërndarja e informatës

Shembuj të attributeve personale

- ndikimi dhe prezenca personale
- entuziazmi
- vetë-besimi
- energjia dhe këmbëngulësia
- besueshmëria
- rigoroziteti intelektual
- integriteti
- çmuarja e vlerave dhe etikave të ndërmarrësisë
- angazhim për mësimnxënie , progres dhe të arritura
- gatishmëria për t'u përshtatur në mjedise të ndryshueshme dhe ide të reja
- realizmi
- sinqeriteti dhe përgjegjësia ndaj tjerëve
- pranimi i nevojave që ndryshojnë, të priturat dhe stilet
- empatia, marrëdhënia dhe respekti për të tjerët
- kategorik/e

KAPITULLI 1 – Karakteristikat e ndërmarrësit të suksesshëm

RM 1

Nxënësit duhet të jenë në gjendje që t'i identifikojnë atributet e ndërmarrësit.

Përmbajtja:

- Mësimi dhe përkufizimi i ndërmarrësit
- Promovimi dhe zhvillimi i cilësive personale të cilat janë të rëndësishme për ndërmarrësi
- Bërja e intervistave me afaristë /ndërmarrës
- Identifikimi i mundësive për karrierë (punësimi dhe vetëpunësimi)
- Numërimi dhe krahasimi i attributeve të ndërmarrësve

IV Prej nxënësit kërkohet që të bëjë një prezantim të shkurtër gojor dhe/ose të përgatisë një dokument të shkurtër (psh. ese, tabelë apo listë).

KR Nxënësi duhet të jetë në gjendje që t'i identifikojë atributet e ndërmarrësit.

RM – Rezultati i mësimit

IV – Instrumenti i vlerësimit

KR – Kriteret e realizimit

NJËSIA MËSIMORE 1

Hyrje në kurs



Përkufizimi i mësimit për ndërmarrësi

Në nivelin fillor, rritja e cilësive, siç janë kreativiteti dhe shpirti i iniciativës, ndihmon në zhvillimin e qëndrimeve për ndërmarrësi. Kjo bëhet më së miri nëpërmjet mësimit aktiv, që bazohet në kureshtjen e natyrshme të fëmijëve. Për më tepër, mësimi për shoqërinë, duhet të përfshijë gjithashtu **njohuritë e hershme** dhe **kontaktin** me botën e punës dhe biznesit dhe të kuptuarit e rolit të ndërmarrësve në komunitet.

Metodat e promovimit të mendimit të hapur drejt ndërmarrësisë, përfshijnë punën në projekte, lojën me role, rastet e studimeve praktike të thjeshta dhe vizitat në ndërmarrjet vendore. Këto janë aktivitetet, që mbështesin një numër të lëndëve dhe motivimin e atyre, që mësojnë më së miri, duke punuar/vepruar.

Grupi Punues Evropian për Arsimimin për Ndërmarrësi, është pajtuar me këtë përkufizim të Mësimit të Ndërmarrësisë dhe objektivat e saj, në nivele të ndryshme të arsimit dhe aftësisë.



Mësimi rreth ndërmarrësisë përfshin zhvillimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe kualiteteve personale, në përputhje me moshën dhe zhvillimin e nxënësit prej shkollës fillore dhe gjatë tërë jetës.



VIZIONI

- ☉ Inkurajimi i **shpirtit të ndërmarrësisë** është thelbësor për krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e konkurrencës dhe zhvillimin ekonomik në Evropë. Në ditët e sotme, rëndësia e **ndërmarrësisë** gjerësisht pranohet si shkathtësi bazë, që mund të ofrohet nëpërmjet mësimit gjatë gjithë jetës.



QËLLIMET

Mësimi për ndërmarrësi, në të gjitha nivelet, ka tri objektiva kryesore:

- Δ ngritja e vetëdijesimit të nxënësve për **vetëpunësim** si një opsion i karrierës (me njoftimin që ai/ajo mund të bëhet jo vetëm punëtor, por edhe ndërmarrës);
- Δ promovimi i zhvillimit të **kualiteteve personale**, që janë relevante për ndërmarrësinë, siç janë kreativiteti, ndërmarrja e rrezikut dhe përgjegjësisë
- Δ ofrimi i shkathtësive teknike dhe **shkathtësive të biznesit**, të nevojshme për të filluar dhe udhëhequr një biznes të ri;

NJËSIA MËSIMORE 2

Kush është ndërmarrësi?

Ndër*ma*rrë*si (em.)



Personi, i cili organizon, punon dhe supozon rrezikun për një ndërmarrje afariste

- American Heritage Dictionary

Çka është saktësisht ndërmarrësi? Kjo fjalë në fjalor përkufizohet si "Personi, i cili organizon, punon dhe supozon rrezikun për një ndërmarrje afariste"¹

Fjalori sugjeron shpjegim më kolorit, me fjalë dhe fraza të ngjashme siç janë: afarist, afariste, ndërmarrës, afarist i vogël; afarist i madh, magnat, ekzekutues i lartë e kështu me radhë!²

Çka do të thotë të jesh ndërmarrës?

Kjo lëndë do t'ju ndihmojë kur të mendoni rreth ëndrrës suaj afariste ose për krijimin e biznesit tuaj, një ditë, si ndërmarrës.

Kjo njësi mësimore do t'ju ndihmojë të kuptoni më shumë se çfarë është ndërmarrësi, do t'ju tregojë se çka nevojitet për të qenë ndërmarrës, do t'iu shpie përgjatë tregimeve apo rasteve të ndryshme të ndërmarrësve dhe do t'ju ndihmojë të bëheni ndërmarrës.



¹ American Heritage Dictionary (2nd College ed.) (1982). Boston: Houghton Mifflin, p. 457.

² Roget's International Thesaurus, (4th ed.) (1977). New York: Harper & Row, p. 830.1.

Ne të gjithë kemi ëndërruar të jemi një ditë yje të sportit, këngëtarë ose yje të filmit, por kur të mësoni më shumë për ndërmarrësinë, kjo do të jetë gjëja e ardhshme fantastike që do të bëheni.

Plani i njësisë mësimore



Pyesni nxënësit tuaj:

Kush janë ndërmarrësit? Si mendojnë dhe çfarë bëjnë ata? Çfarë i veçon ata nga ne tjerët?

Nën seksionin **Çfarë di**, pyesni nxënësit se çfarë dinë tashmë rreth të qenit ndërmarrës. Shënoni përgjigjet e tyre. Nëse është e nevojshme inkurajoni, që ta shtjellojnë tematikën në hollësi.

Gjeni se çfarë dëshirojnë nxënësit të mësojnë rreth të qenit ndërmarrës, duke përdorur teknikën e njëjtë

Çfarë di	Çfarë dua të mësoj

Duke shfrytëzuar pyetjet e nxënësve, mësoni ata/o se si të realizojnë një intervistë me ndonjë ndërmarrës vendor.

Duke punuar në çift, nxënësit diskutojnë pyetjet e njëri tjetrit që i kanë përgatitur për intervistë. Për ushtrimin e teknikës intervistuese, nxënësit së pari intervistojnë njëri-tjetrin.

Pas mbledhjes së të gjitha pyetjeve dhe disa pyetjeve shtesë prej mësimdhënësit, si detyrë shtëpie nxënësit duhet të realizojnë një intervistë me një ndërmarrës, për marrjen e më shumë informacioneve.



Pyetjet për intervistë:

Ku jeni rritur?

Çfarë kanë punuar prindërit tuaj?

Çfarë keni dashur të bëheni si fëmijë?

Si keni filluar të interesoheni për këtë lloj biznesi?

A keni dashur gjithmonë të jeni _____?

A ju ka ndihmuar dikush?

Cilat janë planet tuaja të ardhshme për biznesin tuaj?

Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt, që dëshiron të fillojë një biznes të ri?

NJËSIA MËSIMORE 3

Intervista

Pasi nxënësit ta kenë përfunduar intervistën me një ndërmarrës (ose me një anëtar të familjes, nëse nuk gjen ndonjë ndërmarrës), hapi i ardhshëm do të ishte diskutimi rreth intervistës së tyre dhe prezantimi para shokëve të klasës

Nxënësit duhet të reflektojnë në procesin e intervistës dhe veçanërisht në pyetjet, që u kanë ndihmuar, që intervista e tyre të jetë më e qartë dhe reflektuese.

Plani i njësisë mësimore



Diskutimi në klasë

NJËSIA MËSIMORE 4

Ndërmarrësi në sferën publike

Mësimdhënës, ju lutem vëni këto definicione në dispozicion të nxënësve,. Lexoni së bashku me ta dhe ndihmohuni ta kuptojnë çdo fjalë, që është e panjohur për ta.

Ndërmarrësit janë thjesht ata/o, të cilët e kuptojnë se ka pak ndryshim në mes pengesës dhe mundësisë dhe janë në gjendje që të dyja këto, t'i kthejnë në avantazh të tyre.

Victor Kiam

Ndërmarrës është a) personi, që organizon dhe drejton një biznes, me ndërmarrjen dhe supozimin e rrezikut në të mirë të profitit/fitimit dhe, b) dikush që nuhat një mundësi dhe krijon një organizatë për ushtrimin/vazhdimin e saj, ose thjesht është dikush, që kërkon të ndërtojë një kompani.

Është me rëndësi të kuptohet që ndërmarrës nuk është medoemos, dikush që është i vetëpunësuar (punon për vete). Pasi që gjithnjë e më shumë njerëz vetëpunësohen, duhet të kuptojmë se çfarë i bënë njerëzit ndërmarrës.

Ndërmarrësit iu qasen problemeve dhe mundësive me vizion dhe pasion më të madh, që krijon ndikim më të madh sesa te shumica e njerëzve tjerë. Nëse shumica e njerëzve e marrin situatën prej A deri në B, ndërmarrësi do ta merret prej A deri në Z.

Ndërmarrësit kanë kreativitetin, energjinë, vullnetin dhe guximin që t'i bëjnë gjërat të funksionojnë në botën e biznesit, shërbimeve publike dhe filantropi/bamirësi. Ndërmarrësit marrin rreziqet, duke shpresuar se rreziku do t'iu paguhet.

Ndërmarrësit e biznesit planifikojnë fitimin monetar

Ndërmarrësit socialë planifikojnë komunitetin më të shëndoshë.

Plani i njësisë mësimore



Për fund, a e kanë ndarë nxënësit bashkërisht atë, që kanë mësuar?
Ata do t'i shkruajnë idetë e tyre në kolonën e tretë.

Çfarë kam ditur	Çfarë kam dashur të mësojë	Çfarë kam mësuar

Shumica e ndërmarrësve të suksesshëm fillojnë në fazë të hershme. Ka shumë mësim për tu mësuar dhe sa më shpejt që t'i mësoni, ka më shumë gjasa të jeni i suksesshëm në moshë më të re.

KAPITULLI 2 – Zhvillimi i idesë afariste

RM 2

Nxënësit duhet të jenë në gjendje që t'i mbajnë ndërmend konceptet themelore të idesë afariste

Përmbajtja:

- Përshkrimi i idesë afariste
- Kërkimi, gjetja dhe zgjedhja e ideve afariste (shfrytëzimi i internetit)
- Skicimi dhe vizatimi i idesë afariste
- Prezantimi i idesë afariste

IV Prej nxënësit kërkohet që të bëjë një prezantim të shkurtër gojor dhe/ose të përgatisë një dokument të shkurtër (p.sh. ese, tabelë apo listë).

KR Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të prezantojë ide afariste në mënyrë të përgjithshme dhe të (thjeshtë).

NJËSIA MËSIMORE 1

Çka është ideja afariste?

Plani i njësisë mësimore

Para se të fillojmë, le të flasim shkurtimisht rreth ideve, ëndrrave, vizioneve dhe koncepteve. Secili nga këta terma është i ndërlidhur me procesin e të bërit ndërmarrës. Ju do të gjeni një shumëllojshmëri të mendimeve se çka nënkupton çdo term dhe si ndërlidhet me ndërmarrësinë. Në vijim, dëshirojmë t'ju japim disa pikëpamje për këta terma;

1. Ndërmarrësit vazhdimisht mendojnë për **idetë** – duke kërkuar idenë e ardhshme të rëndësishme. Ata shqyrtojnë çdo gjë në aspektin "si mund të bëhet ndryshe ose si mund të bëhet më mirë". Ata dalin me shumë ide vetëm duke pyetur se si janë bërë shumë gjëra. **Ideja nënkupton – diçka që dikush mendon, di ose parafytyron/imagjinon. Një plan, skemë, projekt ose qëllim.**
2. Posa një ndërmarrës të ketë një ide, që dëshiron ta zhvillojë edhe më tutje– ai fillon të **ëndërrojë**. Ndërmarrësit janë fanatikë (shumë entuziastë – të eksituar) rreth ideve të tyre. Ata/o, gjithashtu, zgjohen për netë të tëra me ide të reja dhe zhvillim më të madh të ideve ekzistuese. **Ëndrra nënkupton – imazhet, mendimet. Një shpresë ose aspiratë e madhe.**
3. **Vizioni** i ndërmarrësve vjen me zhvillimin më të madh të idesë së tyre nëpërmjet mendimeve dhe ëndrrave të shumta. Vizioni është kur ju mund të shihni idenë tuaj në mendje dhe të ëndërroni një pjesë të madhe të saj. Do të shihni se si kjo do të fillojë të funksionojë. Nëse e jepni një ide te një numër i njerëzve dhe kërkonin nga ta, të mendojnë për potencialin e idesë, do të shihni se do të merrni përgjigje të ndryshme. Do të shihni që ndërmarrësi do të zgjerojë kufijtë dhe do të jetë shumë kreativ për mundësitë e idesë. **Vizioni nënkupton – diçka që perceptohet në ëndërr. Aftësia për të dalluar diçka që faktikisht nuk është e dukshme.**
4. **Koncepti** në aspektin e biznesit dhe ndërmarrësve është në të vërtetë një përmbledhje e idesë dhe si parafytyroni që ajo ide të funksionojë. Shume kapitalist të bankave dhe ndërmarrjeve e mendojnë konceptin si fazë e hershme e zhvillimit të biznesit. Koncepti zakonisht përdoret si term për të sugjeruar se ju e keni menduar idenë tejprtej, prej një faze të hershme, por ju nuk jeni duke e zhvilluar atë deri në shkallën, që mendoni se është e mundur. Ju ende nuk e keni shitur produktin ose shërbimin. **Koncepti nënkupton – një ide ose mendim. Një nocion abstrakt.**

NJËSIA MËSIMORE 2

Plani i njësisë mësimore



Shkruani në tabelën e bardhë/zezë uebfaqet, ku nxënësit mund të gjejnë informatat rreth ideve të biznesit ose çdo informatë shtesë rreth kësaj teme. Lërimi të hulumtojnë në internet.

Lista e linqeve



www.marketplaceforkids.com



www.teachingkidsbusiness.com

NJËSIA MËSIMORE 3

A keni ide afariste?

Plani i njësisë mësimore



Nëpërmjet shënimit të ideve/mendimeve, nxënësit duhet t'iu përgjigjen këtyre pyetjeve:

1. A keni ndonjë ide afariste?

2. Çfarë dëshironi të bëheni kur të rriteni?

3. Çfarë dëshironi të keni?

4. Si mendoni se do të mund ta realizoni ëndrrën (dëshirën) tuaj?

NJËSIA MËSIMORE 4

Ideja juaj afariste

Plani i njësisë mësimore



- Shpërndajuni nxënësve tregimin **Stenda e Limonadës** dhe pasi ta kenë lexuar, pyesni nëse ndonjëherë e kanë imagjinuar ndonjë punë sikur kjo...

Tregimi për stendën e limonadës

Kur isha fëmijë, kemi pasur stenda të limonadës, gjatë tërë kohës. Ne jetonim në një rrugë të gjallë, që ishte diçka e përsosur. Automjetet ndalonin dhe udhëtarët blinin limonadë. Njerëzit që ecnin në shtëpi nga metroja, gjithashtu do të ndalonin dhe blinin.

Ne bënim shumë para dhe unë ia atribuoj interesimit tim për ndërmarrësi, ato përvoja të hershme. Ishte kënaqësi të fillojmë punën në shitore me vëllezërit e mi dhe, ende jam duke ndjekur ndjenjën e njëjtë.

Vëllai im më i madh, e ngriti ndërmarrësinë madje në një nivel edhe më të lartë. Ne udhëtuam tek shitësit me shumicë të sheqerkave në qytetin e afërt, u furnizuam me sheqerka dhe më pas ua shitëm fëmijëve të lagjes me çmime të volitshme. Ishte një biznes i vogël, i mirë për ne gjersa nuk u detyruam ta mbyllim për shkak të nënës së njërit nga fëmijët e lagjes. Siç duket, ajo nuk ishte e lumtur që djali i saj kishte disa zgavra në dhëmbë, për të cilat ajo na mbante ne përgjegjës. Prindërit e mi ende jetojnë në rrugën e njëjtë dhe fëmijët e mi patën kënaqësinë të organizojnë stendën e tyre të limonadës, para shtëpisë së gjyshërve të tyre. Kur kushërinjtë e tyre vijën në qytet, ata magjepsen me këtë mundësi të fitimit të parave dhe stenda e limonadës punon çdo ditë derisa ata janë në qytet.



Diskutimi në klasë

KAPITULLI 3 – Shtjellimi i planit afarist

RM 3

Nxënësit duhet të jenë në gjendje që t'i mbajnë ndërmend konceptet themelore të planit afarist.

Përmbajtja:

- Mbajtja ndërmend e hapave lidhur me qëllimet e afarizmit fillestar
- Numërimi i disa detyrave të domosdoshme të afarizmit

IV Një dokument me shkrim që tregon një plan themelor afarist (Ndërtimi i gjarpërit të detyrave dhe një prezantim i shkurtër gojor).

KR Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të disenjojë planin themelor të biznesit (ndërtimi i detyrave gjarpërore) dhe përshkrimi i planit .

NJËSIA MËSIMORE 1


Plani afarist është një formulim formal i qëllimeve afariste, arsyeve përse mendohet se ato mund të arrihen dhe planifikimit për arritjen e këtyre qëllimeve. Gjithashtu, mund të përmbajë historikun rreth organizatës ose ekipit, që bën përpjekje për arritjen e atyre qëllimeve.

Komercializimi i idesë:

- Plani afarist përshkruan planin e përgjithshëm të ndërmarrësisë;
- Plani afarist përfshinë mjedisin ekonomik, objektivat përmbajtësore dhe mjetet, që duhet të përdoren;
- Plani afarist është bazë për shqyrtim të kujdesshëm të pronarëve kryesor.

Vetë-kontrollimi:

- Plani afarist është instrument kontrollimi
- Të menduarit tejprtej të konceptit
- Bazë për kontrollim



Për më shumë informata përdoreni këtë lidhje interneti:
http://en.wikipedia.org/wiki/Business_plan

Pamja e përgjithshme e rolit të planifikimit të planit afarist:

Burimi: *North Dakota Entrepreneur Hall of Fame Inductees Web Site:*
www.innovators.net

NJËSIA MËSIMORE 2 – Tregimi i Z. Mula



Plani i njësisë mësimore



U jepni nxënësve një tregim të shkurtër me shkrim, për afaristin, që dëshirojë të fillojë biznesin e tij, në mënyrë që nxënësit të mundën ta lexojnë tregimin. Shfrytëzoni rezultatet e njësive 1 & 2. U tregoni nxënësve se është i domosdoshëm një plan i veçantë. Formuloni edhe disa pyetje.



a. **Një shembull për tregimin:** Z. Mula ka një ide. Ai është i hapur, komunikues, ka vetëbesim dhe është punëtor i madh. Për më tepër, atij i pëlqen të punojë me njerëz dhe mund ta parafytyrojë veten të jetë i sjellshëm dhe miqësor me punëtorët dhe klientët. Z. Mula i pëlqejnë lëngjet e pemëve dhe tashmë është kujdesur për prodhimtarinë e tyre. Ai do të dëshironte të fillojë personalisht me prodhimin e lëngjeve të pemëve. Mirëpo, nuk e di se sa para i nevojiten, nëse klientët kërkojnë lëngje. Ai filloi të përgatisë një plan. Pa këtë plan ai nuk do të ishte i suksesshëm!



b. Shembuj të pyetjeve

- A do të donit të filloni biznesin tuaj pa plan? Gjeni arsyet për përgjigjet tuaja.
- Nëse mendoni se është e domosdoshme të planifikoni fillimin e biznesit tuaj, atëherë shkruani se çka do të planifikoni.



Pasi nxënësit të lexojnë tregimin, ata/o do të fillojnë të shtrojnë pyetje.

Merrni përgjigjet prej nxënësve dhe shënioni ato.

Pyesni nxënësit se cilat janë përgjigjet. Shënioni përgjigjet në fletat e tabelës së bardhë, pastaj do të mund ta aktivizoni rezultatin.

NJËSIA MËSIMORE 3

Hapat e planit afarist

Plani i njësisë mësimore

Përmbliidhni pjesët themelore të tregimit të z.Mula. Shkruani pjesët e domosdoshme të planit afarist bazë.

Pjesët janë:

- Klientët dhe shitësit,
- Organizimi dhe menaxhimi,
- Produktet dhe shërbimet,
- Investimi dhe financat.



Merrni përgjigjet e mbledhura prej nxënësve (në njësinë mësimore paraprake) dhe krahasoni me pjesët e planit afarist.



Tregoni skicën e fillimit të planit afarist, me 8 detyrat në vijim:

1. Do t'ju shtyjë të shqyrtoni mirë biznesin;
2. Mund të shfrytëzohet si studim i realizueshmërisë ose t'ju ndihmojë për vazhdimin e suksesit;
3. Mjet i mirë për menaxhimin më të mirë;
4. Ndihmon në komunikimin e ideve tuaja;
5. Ndihmon të kaloni prej "reagues" në "pro-aktiv";
6. Drejton çdonjërin në të njëjtin drejtim;
7. Ndihmon në identifikimin e mundësive; dhe
8. Fokuson vëmendjen në pyetjet e rëndësishme.

KAPITULLI 4 – Klientët dhe shitësit

RM 4

Nxënësit duhet të jenë në gjendje që të bëjnë dallimin ndërmjet konsumatorëve dhe shitësve

Përmbajtja:

- Përshkrimi i konsumatorit dhe shitësit tipik
- Identifikimi i interesave të ndryshme të konsumatorëve dhe shitësve

IV Një dokument me shkrim që tregon listën (tabelën) e attributeve kryesore të konsumatorit dhe shitësit.

KR Nxënësit duhet të jenë në gjendje që të tregojnë atributet tipike të konsumatorit dhe shitësit.

NJËSIA MËSIMORE 1

Klienti vs. Shitësit

Duhet të dini diçka rreth asaj se si duhet të funksionojë një treg.



Tregu është një vend fizik ose virtual. Në atë vend, takohen kërkesa dhe oferta dhe gjithashtu formohen çmimet.

- Në këtë nivel, fjala **ofertë** do të zëvendësohet me fjalën **shitës** dhe fjala **kërkesë** me **klient**.



Shih gjithashtu: <http://en.wikipedia.org/wiki/Marketplaces>.

Plani i njësisë mësimore

Duhet të filloni me një hyrje. Tregoni disa shembuj të tregjeve, si interneti apo tregjet e gjelbërta.



Pyesni nxënësit disa **pyetje** si:

- Në cilin rast do të donit të blini lëng pemësh?
 - Ku do ta blinit lëngun e pemëve?
- etj.



Shkruani **fjalët kryesore** në dërrasën e zezë dhe **gruponi** temat pas parashtrimit të pyetjeve.

- Grupet e mundshme janë:
 - Karakteristikat e lëngjeve të pemëve;
 - Shitësit e ndryshëm
 - Preferencat e klientëve.

1. **Identifikoni interesat e ndryshme të shitësve dhe klientëve:**

Interesat	Shitësi	Klienti
Vlera e çmimit	Shitësi dëshiron të ketë çmim më të lartë.	Klienti dëshiron të paguajë çmim më të ulët.
Kush është përgjegjës, nëse ndodh diçka, për shembull nëse dëmtohet produkti gjatë blerjes?		
Ku blini?	Shitësi dëshiron që klienti të blejë prej tij.	Klienti nuk e njeh shitësin. Për këtë arsye ai shkon te një shitës tjetër.

NJËSIA MËSIMORE 2


Markat prej shitësve dhe fotografitë prej klientëve

Plani i njësisë mësimore



Nxënësit duhet të mbledhin markat prej kompanive dhe duhet t'i ndërlidhin me fotografitë prej klientëve tipik.

- **Rezultati** duhet të jetë një vizatim ose kolazh.
 - Shembull:



KAPITULLI 5 – Organizimi dhe menaxhimi

RM 5

Nxënësit duhen të jenë në gjendje të bashkëpunojnë dhe t'i tolerojnë rolet dhe nevojat e të tjerëve.

Përmbajtja:

- Formimi i ekipit
- Ndërtimi i marrdhënieve të mira
- Puna në grupe
- Zgjedhja dhe ndarja e përgjegjësive

IV Një dokument me shkrim që bëhet nga nxënësi dhe vëzhgimi i punës grupore nga trajnuesi/mësuesi.

KR Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të përgatisë një listë të thjeshtë të përgjegjësive për secilin anëtar të ekipit.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të tolerojë mendimin e të tjerëve dhe të pranojë rolin e tyre në ekip.

NJËSIA MËSIMORE 1

Kush do të më ndihmojë?


Plani i njësisë mësimore

1. Formoni grupet prej katër nxënësish.
2. Çdo grup e ka për detyrë "përgatitjen e lëngjeve të pemëve".
3. Ndarjen dhe menaxhimin e përgjegjësive
 - **Për shembull:**
 - Një nxënës ka përgjegjësi të blejë pemët.
 - Një nxënës përgatit lëngun
 - Një nxënës shet lëngun
 - Një nxënës llogarit shpenzimet dhe fitimet
4. Ndhimesa e njëri-tjetrit për të gjetur rolin.
5. Organizimi i orarit të punës.
 - a. **Për shembull:** Së pari duhet të blini pemët dhe mandej mund të prodhoni lëngun e më pas e shitni atë.
6. Lini të luajnë rolin e tyre.
7. Vrojtoni nxënësit gjersa aktrojnë rolin e tyre. Në veçanti janë të rëndësishme pikat në vijim:
 - a. A punojnë nxënësit mirë së bashku?
 - b. A ka marrëdhënie të veçanta?
 - c. A i luajnë rolet e tyre apo nuk çajnë fare kokën për to?
 - d. A ka ndonjë polemikë?
 - e. A ka ndonjë rritje të rezultatit për shkak të punës së tyre të përbashkët?



Shënoni rezultatet dhe jepuni nxënësve informatën kthyesë nëse kanë punuar mirë ose dobët. Informata kthyesë duhet të bëhet duke përdorur pyetjet prej pikës 7 dhe transferimin e tyre në definicione të organizimit.

Për shembull:



NJËSIA MËSIMORE 2

Lëng i freskët pemësh

Lini nxënësit të reflektojnë rreth rezultateve të njësisë mësimore "Kush do të më ndihmojë"?

Jepuni një fletë pune, ku duhet t'i përshkruajnë rolet që i kanë pasur. Ata duhet të bëjnë një listë të përgjegjësive.

Ndani përgjegjësitë sipas mënyrës në vijim:

- Përgjegjësitë e rolit të tyre,
- Përgjegjësitë e roleve të tjera.

Jepni nxënësve informatën kthyesë në atë mënyrë, që do ta kontrolloni fletën e punës.



Nxënësit, gjithashtu, mund të kërkojnë shembuj të organizatave në internet.



Përdorni një tabelë për përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit

Anëtar i ekipit	Blerja e pemëve	Përgatitja e lëngut	Furnizimi me pajisje	Marketingu	Shitja	Menaxhimi
X						
Y						
Z						
V						

KAPITULLI 6 – Produktet dhe shërbimet

RM 6

Nxënësit duhen të jenë në gjendje ta bëjnë dallimin ndërmjet produkteve dhe shërbimeve.

Përmbajtja:

- Të qenit kreativ me burimet
- Bërja e produktit
- Krijimi i shërbimeve

IV Prej nxënësit kërkohet që t'u përgjigjet pyetjeve të shkurtëra (gojarisht dhe me shkrim)

KR Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të tregojë rëndësinë e të qenit kreativ dhe ekonomik me burimet.

Nxënësit duhet të jenë në gjendje që të bëjnë dallimin ndërmjet produkteve dhe shërbimeve.

NJËSIA MËSIMORE 1

Produkti dhe shërbimet

Ju duhet të jeni në gjendje të përshkruani produktet dhe shërbimet. Gjithashtu duhet të dini dallimin dhe ta definoni te nxënësit.



Produkti është diçka që mund ta depononi, shpesh edhe ta prekni. Gjithashtu, produktin mund edhe ta riprodhoni.



Shërbimi është diçka që nuk mund ta depononi apo ta riprodhoni në mënyrë të njëjtë.




Shih gjithashtu:

- Produkti: [http://en.wikipedia.org/wiki/Product_\(business\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Product_(business))
- Shërbimi: <http://en.wikipedia.org/wiki/Service>

Plani i njësisë mësimore

Shkëmbimi i mendimeve: Kërkoni nga nxënësit të japin disa shembuj për produkte.

1. **Shënoni** shembujt në tabelën e bardhë/zezë. Me siguri nxënësit gjithashtu do të përmendin automatikisht edhe shërbimet tipike
2. **Gruponi** produktet dhe shërbimet pas fazës së shkëmbimit të mendimeve.
3. **Hyrje:** Definoni produktet dhe shërbimet.
 - a. Tregojuni atributet e të dyjave
 - b. Tregojuni për dallimet e të dyjave
 - c. Tregojuni se ka nevojë edhe për gjëra shtesë për prodhimin e produktit ose shërbimit.
 - i. Për shërbime ju duhet kohë.
 - ii. Për produkte përdorni shembullin për lëng të pemëve.




NJËSIA MËSIMORE 2

Marka, produktet dhe shërbimet

Plani i njësisë mësimore

- **Kolazhi prej njësisë së 4-të:** Vizatimi ose kolazhi, që është krijuar në njësinë mësimore "Markat prej shitësve dhe fotografitë prej klientëve", duhet të përdoret si bazë për këtë njësi. Nxënësit duhet t'i ndërlidhin markat e gjetura me produktet dhe/ose shërbimet dhe t'i ngjeshin të gjitha kolazhet në mur.



- **Zgjedhje alternative:** Me siguri do të ndodh që produktet dhe shërbimet mos të përputhen me asnjë markë. Nxënësit duhet ta dinë këtë dhe të gjejnë ndonjë zgjedhje alternative.
- **Detyrë shtëpie:** Pyesni nxënësit se çfarë dëshirojnë të prodhojnë. Nxënësit duhet të shkruajnë për detyrë shtëpie se çfarë gjëra shtesë u nevojiten.
- **Informata kthyese:** Korrigjoni detyrat e shtëpisë dhe jepuni nxënësve informatën kthyese.

KAPITULLI 7 – Investimet dhe financat

RM 7

Nxënësit duhen të jenë në gjendje që të tregojnë se cili është fitimi dhe të vërejnë investimin.

Përmbajtja:

- Sjellja me paratë e xhepit
- Të kuptuarit se çka janë investimet
- Kursimi i parave për investime
- Të kuptuarit se çfarë ndodh nëse nuk ka para të mjaftueshme

IV Një dokument me shkrim apo test gojor që i përgjigjet pyetjes:

“A kam para të mjaftueshme për të blerë pajimet e nevojshme? Sa para më nevojiten? Sa fitoj me shitjen e produktit?”

KR Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të llogarisë fitimin me llogari të thjeshtë (duke i numëruar paratë e gatshme në dorën e tij)

NJËSIA MËSIMORE 1

Investimet dhe financat

Duhet të jeni në gjendje të kuptoni bazat e investimeve dhe financave.



Investimi

Në rast të kompanisë, financat e menaxhmentit ose financat e korporatës e kanë për detyrë t'i sigurojnë mjetet financiare për aktivitetet e korporatës.



Financat

Kapital afatgjatë për fitimin e profiteve të ardhshme autonome.



Shih gjithashtu:

- Financat: http://en.wikipedia.org/wiki/Finances#Business_finance
- Investimet: http://en.wikipedia.org/wiki/Investments#Business_Management

Plani i njësisë mësimore

Hulumtimi i çmimeve: Nxënësit duhet të hulumtojnë në tregje, për çmimet e lëndëve përbërëse, që nevojiten për prodhimin e lëngjeve të pemëve. Ata duhet të krahasojnë çmimet e produkteve të njëjta.

Rezultatet mund të paraqiten në një tabelë.

Produkti	Çmimi	Njësia	Shitësi
limon	0,10 €	për copë	Mula
limon	0,11 €	për copë	Edeka
sheqer	0,50 €	për kg	Edeka
sheqer	0,52 €	për kg	Mula

Puna me paratë e xhepit:



Pyesni nxënësit nëse marrin para xhepi dhe sa i marrin në muaj.

- Jepuni nxënësve recetën për përgatitjen e 10 litrave të lëngut të pemëve. Llogaritni çmimin e plotë të fundit të lëngut të pemëve.

Shembull: Çmimi i plotë për përgatitjen e lëngut të pemëve është 0,50 € / litër. Çmimi i plotë për dhjetë litra është 5,00 €

Produkti	Njësitë nevojshme	Shitësi me çmime më të ulëta	Shuma
limoni	4 copë	0,1 €	0,40 €
sheqer	0,2 kg	0,5 €	0,10 €
Shuma			0,50 €



Pyesni nxënësit nëse kanë mjaft para në muaj, për përgatitjen e lëngut të pemëve.

Nëse nuk kanë mjaft para, pyesni nxënësit se sa kohë u duhet të kursejnë para, për të përgatitur lëngun e pemëve.

NJËSIA MËSIMORE 2

Lëng i freskët pemësh

Plani i njësisë mësimore

1. Tregojuni nxënësve **profitin**, nëse e kanë shitur lëngun për litër më shumë, sesa që kanë paguar për përgatitjen e tij.

Shembull: Çmimi me pakicë është 1, 50 €/litër

$1, 50 \text{ €} - 0, 50 \text{ €} = 1, 00 \text{ €}$ profit për 1 litër

$1, 00 \text{ €} * 10 = 10, 00 \text{ €}$ profit për 10 litra

Pyesni nxënësit se çka ndodh nëse shesin lëngun e pemëve vetëm për 0,40 €/litër.

A do të vazhdonin nxënësit të prodhojnë lëng pemësh?

2. Tregojuni nxënësve **humbjen**.

Shembull: Klientët paguajnë vetëm 0, 40 €/litër

$0, 40 \text{ €} - 0, 50 \text{ €} = 0, 10 \text{ €}$ humbja për litër

$0, 10 \text{ €} * 10 = 1, 00 \text{ €}$ humbja për litër

KAPITULLI 8 dhe 9 – Loja me role dhe vlerësimi

RM 8

Nxënësit duhet të jenë në gjendje që të imitojnë apo realizojnë një aktivitet të thjeshtë të ndërmarrësisë

Përmbajtja:

- Luajtja e rolit "Si të fillojmë, udhëheqim dhe mbyllim një ndërmarrje të vogël"

IV Vëzhgimi i realizimit apo i luajtjes së rolit nga trajnuesi/mësuesi.

KR Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të imitojë fillimin, udhëheqjen dhe mbylljen e "ndërmarrjes së vogël"

R M 9

Nxënësit duhet të jenë në gjendje që të diskutojnë procesin mësimor dhe realizimin e tyre.

Përmbajtja:

- Reflektimi në procesin mësimor
- Roli i individit
- Ekipi dhe individi si pjesë e ekipit

IV Diskutim apo dokument me shkrim/ese i shkurtër.

KR Nxënësi duhet të jetë në gjendje të shprehë se çfarë ai ka menduar se ishte pozitive gjatë përvojës së mësimit dhe çfarë mund të ndryshohet.

Loja me role: është një vegël e shkëlqyer e mësimdhënies dhe nxënies

Kjo ofron të nxënit me të gjitha kuptimet – të njohjes, emocionale dhe të sjelljes.

Synimi dhe objektivat

Synimi:

- Shqyrtimi i mundësisë, që ofron loja me role për mësimin rreth ndërmarrësisë.

Objektivat:

- Të identifikojë vlerën e lojës me role si vegël e të nxënit
- Të kërkojë shumëllojshmërinë e aspekteve të shfrytëzimit të lojës me role
- Të imitojë personin, që i përshtatet attributeve të dëshiruara
- Të aktrojë dhe vrojtojë pjesët e lojës me role

Hapi i parë i aktivitetit për nxënësit duhet të jetë identifikimi i attributeve të tyre të ngjashme me atributet e rolit, që kanë zgjedhur të luajnë (imitojnë).

Hapi i dytë duhet të jetë organizimi i skenës për lojën me role, gjetja e kostumeve të duhura dhe fillimi i roleve.

Hapi i tretë është i realizimi i lojës me role, përfundimi dhe lënia e roleve.

Hapi i fundit, si informatë kthyese prej nxënësve (aktorët dhe vrojtuesit/audienca), duhet të jetë reflektimi për përvojat që kanë marrë prej realizimit.



Diskutimi në klasë

Shembull:

Organizoni nxënësit në ekipe për të debatuar çështjen e biznesit në vijim, që prek çështjet e mjedisit.

Aneks - Materiali i shtypur (Materialet e mësimdhënies)

KAPITULLI 1: Karakteristikat e ndërmarrësit të suksesshëm
NJËSIA MËSIMORE 2

Çfarë di	Çfarë dua të mësoj

NJËSIA MËSIMORE 4

Çfarë kam ditur	Çfarë kam dashur të mësoj	Çfarë kam mësuar

KAPITULLI 2 – Zhvillimi i idesë afariste

NJËSIA MËSIMORE 3

1. A keni ndonjë ide afariste?

2. Çfarë dëshironi të bëheni kur të rriteni?

3. Çfarë dëshironi të keni?


3. Si mendoni se mund ta realizoni ëndrrën (dëshirën) tuaj?

NJËSIA MËSIMORE 4

Ideja ime afariste:

KAPITULLI 3 - Plani afarist NJËSIA MËSIMORE 1 DHE 2

Ilustrimi i zinxhirit të detyrave



KAPITULLI 4 - Klientët dhe shitësit
NJËSIA MËSIMORE 1

Atributet	Shitësi	Klienti

KAPITULLI 5

Tabela e përgjegjësisë

Anëtar i ekipit	Blerja e pemëve	Përgatitja e lëngut	Furnizimi me pajisje	Marketingu	Shitja	Menaxhimi
X						
Y						
Z						
V						

KAPITULLI 6

Produktet dhe shërbimet

	Produkti	Shërbimi
Pizza	+	Dërgesa
Celulari	+	
Librat	+	Biblioteka
TV	+	Mirëmbajtja
...		
...		
...		
...		

KAPITULLI 7

Investimet dhe financat

Llogaritni fitimin dhe humbjen nëse prodhoni dhe shitni produktin tuaj.